



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 65

Tiranë – E enjte, 10 prill 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 23/2025, datë 17.3.2025	Për Bankën Shqiptare të Zhvillimit..... 7599
Dekret i Presidentit nr. 109, datë 8.4.2025	Për shpallje ligji..... 7605
Ligj nr. 24/2025, datë 17.3.2025	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 75/2019, “Për rininë”..... 7606
Dekret i Presidentit nr. 108, datë 7.4.2025	Për shpallje ligji..... 7609
Urdhër i drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Kontrollit të <i>Cannabis</i> -it nr. 59, datë 8.4.2025	Për delegimin e kompetencave..... 7610
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 13.2.2025	Jorgo Qiqi kundër Shqipërisë (<i>kërkesa nr. 1541/13</i>)..... 7610
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 27.2.2025	Marius Tafa kundër Shqipërisë (<i>kërkesa nr. 1840/23</i>)..... 7613
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 6.3.2025	Edmond Peshkopia dhe Bardhyl Talipi kundër Shqipërisë (<i>kërkesa nr. 16351/15</i>)..... 7614
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 6.3.2025	Majlinda Zorba kundër Shqipërisë (<i>kërkesa nr. 40224/18</i>)..... 7616
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 13.2.2025	Drita Xheka kundër Shqipërisë (<i>kërkesa nr. 57726/21</i>)..... 7618
Vendim i Komisionit të Ndhmës Shtetërore nr. 123, datë 24.1.2025	Autorizim i ndihmës shtetërore “Fondi për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme për vitin 2025”..... 7618



LIGJ
Nr. 23/2025

PËR BANKËN SHQIPTARE
TË ZHVILLIMIT

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim krijimin e Bankës Shqiptare të Zhvillimit, si dhe përcaktimin e rregullave për regjistrimin, organizimin dhe funksionimin e veprimtarisë së saj.

Neni 2
Objektivi

1. Banka Shqiptare e Zhvillimit ka si objektiv kryesor nxitjen e zhvillimit ekonomik, social e mjedisor, në përputhje të plotë me kërkesat e legjislacionit për ndihmën shtetërore.

2. Banka Shqiptare e Zhvillimit, në përputhje me objektivin e saj kryesor dhe në përputhje të plotë me kërkesat e legjislacionit për ndihmën shtetërore, nxit e mbështet lehtësimin e qasjes në financë, kryesisht përmes financimit dhe mbështetjes së sipërmarrjeve në sektorët e nënfinancuar të ekonomisë, si dhe përfshirjen në sistemin financiar të individëve, që nuk u ofrohet shërbim i plotë nga sistemi bankar.

Neni 3
Parimet

Banka Shqiptare e Zhvillimit, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, udhëhiqet nga këto parime:

a) mbështetja e zhvillimit ekonomik e social nëpërmjet lehtësimit të qasjes në financa dhe

përmirësimit të kushteve për sektorët strategjikë të ekonomisë;

b) promovimi i partneriteteve dhe i bashkëpunimit me institucione financiare kombëtare e ndërkombëtare për të mbështetur investimet dhe rritjen ekonomike;

c) promovimi i interesit publik, duke mbështetur projekte me ndikim afatgjatë në zhvillimin ekonomik e social të vendit;

ç) qëndrueshmëria dhe ekuilibri financiar;

d) transparenca dhe llogaridhënia, duke siguruar menaxhim të përgjegjshëm e të hapur të fondeve dhe burimeve financiare;

dh) përputhshmëria me politikat dhe praktikrat më të mira ndërkombëtare të monitorimit dhe menaxhimit të riskut financiar;

e) pavarësia operationale dhe garantimi i vendimmarrjes së paanshme, në përputhje me legjislacionin për ndihmën shtetërore;

ë) ndarja e qartë e aktiviteteve promovuese dhe tregtare, duke shmangur çdo formë subvencionimi të ndërsjellë mes këtyre aktiviteteve;

f) përputhshmëria me standardet financiare dhe ligjore nëpërmjet ndarjes së sistemeve financiare dhe të raportimit.

Neni 4
Veprimtaria e Bankës Shqiptare të Zhvillimit

1. Banka Shqiptare e Zhvillimit ushtron veprimtaritë e mëposhtme:

a) financimin me karakter promovues:

i. kredidhënia për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, si dhe *startup*-et vendase për të nxitur rritjen, produktivitetin, konkurrueshmërinë dhe zgjerimin në tregjet ndërkombëtare;

ii. kredidhënia dhe mbështetja për eksportet e mallrave dhe shërbimeve vendase;

iii. kredidhënia për projektet publike në nivel qendror e vendor, me përparësi për ekonominë e vendit;

iv. kredidhënia për zhvillimin, përmirësimin e modernizimin e infrastrukturës fizike dhe digjitale të vendit, në përputhje me objektivat strategjikë kombëtarë;

b) kredidhënien për shoqëritë tregtare vendase bazuar në kushtet e tregut dhe në parimet e konkurrencës së lirë, si veprimtari plotësuese e financimit të ofruar nga bankat tregtare.



2. Në ushtrimin e veprimtarisë së saj, Banka Shqiptare e Zhvillimit:

a) jep kredi dhe kryen investime financiare drejtpërdrejt ose në bashkëfinancim me institucione vendase ose ndërkombëtare;

b) vendos dhe pranon fonde afatshkurtra e afatgjata në dhe nga bankat tregtare apo institucionet e tjera financiare;

c) lëshon garanci dhe instrumente të tjera sigurie;

ç) investon në tituj;

d) kryen aktivitete dhe shërbime të tjera financiare të nevojshme;

dh)vepron si agjent për grante në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave.

3. Banka Shqiptare e Zhvillimit kryen, në kushte tregu dhe bazuar në parimet e konkurrencës, drejtpërdrejt ose nëpërmjet shoqërive apo degëve të saj çdo aktivitet ndihmës, përfshirë financimin e kapitalit privat dhe mbajtjen e aksioneve në shoqëri me qëndrueshmëri financiare.

Neni 5

Emri i shoqërisë, personaliteti juridik dhe selia

1. Banka Shqiptare e Zhvillimit themelohet si person juridik në formën e një shoqërie aksionare.

2. Banka Shqiptare e Zhvillimit vepron nën emrin tregtar “Banka Shqiptare e Zhvillimit” sh.a. dhe me emrin e shkurtuar “BZH”.

3. Selia e regjistruar e Bankës Shqiptare të Zhvillimit ndodhet në Tiranë.

4. Banka Shqiptare e Zhvillimit ka vulën e vet, e cila përmban emrin e saj të plotë, emrin e shkurtuar dhe selinë.

5. Banka Shqiptare e Zhvillimit mund të krijojë shoqëri dhe degë.

Neni 6

Aksionarët

1. Aksionari i parë i Bankës Shqiptare të Zhvillimit është shteti shqiptar. Këshilli i Ministrave përcakton me vendim ministrinë përgjegjëse, që përfaqëson shtetin shqiptar në cilësinë e aksionarit.

2. Përveç shtetit shqiptar, aksionet në Bankën Shqiptare të Zhvillimit mund të zotërohen nga institucione financiare ndërkombëtare e vendase të njohura, si dhe nga entitete të tjera ndërkombëtare dhe vendase të njohura.

3. Pjesëmarrja e shtetit shqiptar nuk do të jetë më e vogël se 51% e kapitalit të regjistruar të aksioneve në çdo kohë. Aksionet e mbajtura nga shteti shqiptar për të ruajtur këtë pjesëmarrje minimale do të jenë të patransferueshme.

4. Procedurat, kriteret dhe formula e pjesëmarrjes për aksionarët e tjerë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 7

Kapitali aksionar dhe llogaritë e dedikuara

1. Kapitali fillestar i Bankës Shqiptare të Zhvillimit, i kontribuar dhe i nënshkruar nga shteti shqiptar, është 10 000 000 000 (dhjetë miliardë) lekë.

2. Kapitali fillestar shlyhet në kështe brenda një afati 4-vjeçar, siç përcaktohet në statutin e Bankës Shqiptare të Zhvillimit. Kësti i parë i kapitalit aksionar është 1 000 000 000 (një miliard) lekë dhe do të shlyhet brenda vitit 2026.

3. Pjesëmarrja e aksionarëve të tjerë në kapitalin aksionar të Bankës Shqiptare të Zhvillimit, përfshirë të drejtat dhe detyrimet përkatëse, lidhur me nënshkrimin dhe shlyerjen e kapitalit aksionar, përcaktohet në statutin e saj.

4. Banka Shqiptare e Zhvillimit respekton standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare të mjaftueshmërisë së kapitalit gjatë të gjithë veprimtarisë së saj.

5. Banka Shqiptare e Zhvillimit mund të hapë, të administrojë dhe të mbajë llogari bankare në Thesarin e Shtetit, në Bankën e Shqipërisë, si dhe në banka vendase e ndërkombëtare, sipas nevojës për të mbështetur aktivitetet dhe për të arritur objektivat e saj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

6. Procedura për menaxhimin e llogarisë në Thesarin e Shtetit, përfshirë mundësinë e dhënies së normës së interesit dhe përlogaritjen e kësaj norme, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 8

Burimet financiare

Burimet financiare të Bankës Shqiptare të Zhvillimit sigurohen nëpërmjet mekanizmave të ndryshëm, si:

a) linjat e kredisë nga institucionet financiare ndërkombëtare;

b) pranimi i fondeve të kthyeshme nga publiku, veçanërisht nga individët që nuk u ofrohet shërbim



i plotë nga sistemi bankar, në formën e produkteve të kursimit, nëpërmjet një entiteti të veçantë të Postës Shqiptare sh.a. Shuma e pranuar e këtyre fondeve nga Banka Shqiptare e Zhvillimit nuk duhet të jetë më e lartë se 2 (dy) për qind e prodhimit të brendshëm bruto.

Llojet e produkteve, karakteristikat e tyre, përfshirë kufizimet në vlerë, përcaktohen me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për financat dhe të ministrit përgjegjës për ekonominë, duke respektuar parimet e përcaktuara në këtë ligj, si dhe kufijtë monetarë të përcaktuar në ligjin që rregullon sigurimin e depozitave. Produktet e kursimit të mbledhura nga publiku garantohen me garanci shtetërore dhe përdoren për aktivitete promovuese;

c) instrumente të tjera financiare të garantuara, rast pas rasti, me garanci shtetërore, duke respektuar parimet e përcaktuara në ligjin që rregullon huamarrjen shtetërore. Emetimi i titujve të garantuar me garanci shtetërore nuk u nënshtrohet parashikimeve të ligjit që rregullon tregjet e kapitalit; ç) burime të tjera financimi.

Neni 9

Roli i Postës Shqiptare sh.a.

1. Subjekti ndërmjetës për mbledhjen e fondeve të kthyeshe nga publiku, sipas këtij ligji, është entiteti i veçantë i Postës Shqiptare sh.a. Këshilli i Ministrave përcakton me vendim kushtet kryesore të marrëdhënies ndërmjet entitetit të veçantë dhe Bankës Shqiptare të Zhvillimit.

2. Bazuar në kushtet kryesore të përcaktuara sipas pikës 1 të këtij neni, entiteti i veçantë i Postës Shqiptare sh.a. dhe Banka Shqiptare e Zhvillimit nënshkruajnë një marrëveshje bashkëpunimi, e cila rregullon aspektet kryesore të funksionimit e të administrimit të fondeve të mbledhura dhe shpërndarjes së produkteve të përcaktuara në shkronjën “b”, të nenit 8 të këtij ligji. Kjo marrëveshje përcakton minimalisht:

a) procedurat operacionale për shpërndarjen dhe administrimin e produkteve financiare;

b) interesat e zbatueshëm për produktet financiare të ofruara;

c) detyrimin për informimin e transparencën ndaj publikut mbi produktet.

Neni 10

Përgjegjësia për detyrimet

Përveç sa parashikohet në shkronjat “b” dhe “c”, të nenit 8 të këtij ligji, përgjegjësia e Bankës Shqiptare të Zhvillimit për detyrimet që lidhen me aktivitetet e tjera do të jetë në përputhje me parimet e legjislacionit shqiptar, që rregullon shoqëritë tregtare.

KREU II

STRUKTURA ORGANIZATIVE

Neni 11

Organe të vendimmarrjes dhe të drejtimit

1. Organizimi dhe administrimi i Bankës Shqiptare të Zhvillimit siguron vendimmarrje dhe drejtim efikas. Banka Shqiptare e Zhvillimit funksionon përmes katër organeve kryesore, secili me përgjegjësi dhe role të përcaktuara për të garantuar transparencë, llogaridhënie dhe drejtim strategjik.

2. Organet e vendimmarrjes dhe të drejtimit janë:

a) Asambleja e Përgjithshme;

b) Këshilli Mbikëqyrës;

c) Këshilli i Administrimit;

ç) Komiteti i Kontrollit.

3. Përbërja, funksionimi dhe përgjegjësitë e këtyre organeve përcaktohen në statutin e Bankës Shqiptare të Zhvillimit.

Neni 12

Asambleja e Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme shërben si organi më i lartë vendimmarrës i Bankës Shqiptare të Zhvillimit. Ajo përbëhet nga përfaqësuesit e aksionarëve dhe ka autoritetin:

a) të miratojë statutin dhe ndryshimet e tij;

b) të përcaktojë objektivat dhe qëllimet strategjike të përgjithshme;

c) të miratojë raportet vjetore dhe pasqyrat financiare;

ç) të emërojë dhe të shkarkojë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës;

d) të emërojë dhe të shkarkojë anëtarët e Komitetit të Kontrollit;

dh) të emërojë dhe të shkarkojë audituesin ligjor të jashtëm;



e) të miratojë skemën e pagave për Këshillin Mbikëqyrës dhe Komitetin e Kontrollit.

2. Kompetencat e hollësishme të përmendura në pikën 1 të këtij neni, procedurat e vendimmarrjes dhe të drejtat e votës të Asamblesë së Përgjithshme përcaktohen në statutin e Bankës Shqiptare të Zhvillimit.

Neni 13

Këshilli Mbikëqyrës

1. Këshilli Mbikëqyrës mbikëqyr drejtimin strategjik dhe administrimin e përgjithshëm të Bankës Shqiptare të Zhvillimit, duke siguruar përputhshmërinë me statutin, kuadrin ligjor dhe rregullator, si dhe mbrojtjen e stabilitetit financiar dhe objektivave afatgjatë.

2. Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga një numër tek anëtarësh, të paktën 5 (pesë), por jo më shumë se 9 (nëntë), ku shumica, përfshirë kryetarin, janë të pavarur.

3. Përfaqësimi i sektorëve të ekonomisë në Këshillin Mbikëqyrës përcaktohet në statutin e Bankës Shqiptare të Zhvillimit.

4. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës emërohen për një mandat 3-vjeçar, me mundësi riemërimi.

5. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës ushtrojnë kompetencat e tyre me standardet më të larta etike, duke vepruar me besim të plotë, kujdes, dinjitet e përgjegjshmëri, si dhe me dedikim për detyrat e tyre.

Neni 14

Roli dhe përgjegjësitë e Këshillit Mbikëqyrës

1. Këshilli Mbikëqyrës ushtron kompetenca mbikëqyrëse dhe ka të drejtën të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për realizimin e objektivave të Bankës Shqiptare të Zhvillimit, siç janë përcaktuar në këtë ligj, përveç kompetencave që i rezervohen Asamblesë së Përgjithshme sipas këtij ligji dhe statutit.

2. Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës përfshijnë, por nuk kufizohen në:

a) propozimin e ndryshimeve në statut për miratim nga Asambleja e Përgjithshme;

b) miratimin e strategjisë, të planit të biznesit e të produkteve kryesore;

c) miratimin e strukturës organizative të Bankës Shqiptare të Zhvillimit;

ç) miratimin e projekteve të investimeve dhe iniciativave të tjera, në përputhje me përcaktimet e statutit;

d) miratimin e politikës së menaxhimit të riskut financiar dhe likuiditetit për të siguruar stabilitetin financiar;

dh) përcaktimin e treguesve për mbikëqyrjen e performancës;

e) emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit të Administrimit;

ë) përcaktimin e pagave e të shpërblimeve për anëtarët e Këshillit të Administrimit dhe administratën;

f) krijimin e komitetit të riskut dhe komiteteve të tjera të brendshme.

3. Këshilli Mbikëqyrës ushtron detyra të tjera shtesë, siç përcaktohet nga ky ligj, ligji që rregullon shoqëritë tregtare dhe statuti.

4. Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës detajohen në statutin e Bankës Shqiptare të Zhvillimit.

Neni 15

Këshilli i Administrimit

1. Banka Shqiptare e Zhvillimit administrohet nga Këshilli i Administrimit, i cili shërben si organ ekzekutiv i drejtim.

2. Këshilli i Administrimit mund të përbëhet nga një ose më shumë administratorë dhe emërohet nga Këshilli Mbikëqyrës për një mandat deri në 3 (tre) vjet, me mundësi rinovimi. Njëri prej administratorëve do të jetë Administratori i Përgjithshëm. Emërimi bazohet në meritë dhe në përmbushjen e kriterëve të përshtatshmërisë dhe të aftësisë.

3. Numri i administratorëve, procesi i emërimit dhe kushtet e angazhimit të Këshillit të Administrimit detajohen në statut.

4. Këshilli Mbikëqyrës ka autoritetin për të shkarkuar Këshillin e Administrimit në rastet e mospërmbushjes së detyrave, keqadministrimit dhe mospërputhjes me kërkesat ligjore ose në rrethana të tjera të justifikuara, siç përcaktohet në statut.

Neni 16

Roli dhe përgjegjësitë e Këshillit të Administrimit

1. Këshilli i Administrimit është përgjegjës për administrimin e përditshëm dhe operacionet e Bankës Shqiptare të Zhvillimit, duke përfshirë:



a) zbatimin e strategjive, të planeve të biznesit dhe politikave të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme dhe Këshilli Mbikëqyrës;

b) menaxhimin e burimeve, të financave dhe aktiviteteve operative, në përputhje me objektivat dhe kuadrin ligjor të tij;

c) përfaqësimin në marrëdhëniet me palë të treta, përfshirë autoritetet shtetërore, palët e interesuara dhe entitete të tjera;

ç) hartimin dhe dorëzimin e raporteve vjetore, pasqyrave financiare dhe vlerësimeve të performancës për Këshillin Mbikëqyrës;

d) propozimin e iniciativave të reja, projekteve të investimeve dhe politikave për miratim nga Këshilli Mbikëqyrës;

dh) miratimin e projekteve të investimeve në përputhje me objektivat, strategjinë, planin e biznesit, sipas përcaktimeve të statutit;

e) sigurimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregullat përkatëse, si dhe kontrollin e brendshëm në operacione;

ë) menaxhimin e strukturave administrative të brendshme, duke përfshirë punësimin dhe mbikëqyrjen e stafit.

2. Kompetencat e Këshillit të Administrimit detajohen në statutin e Bankës Shqiptare të Zhvillimit.

Neni 17

Komiteti i Kontrollit

1. Komiteti i Kontrollit mbikëqyr raportimin financiar, kontrollet e brendshme dhe proceset e auditimit, dhe përbëhet nga 3 (tre) anëtarë të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme për një periudhë deri në 3 (tre) vjet, nga të cilët kryetari i Komitetit është anëtar i Këshillit Mbikëqyrës, me të drejtë riemërimi.

2. Komiteti i Kontrollit gjatë ushtrimit të funksioneve të tij mund të ndihmohet nga ekspertë të jashtëm të zgjedhur prej tij.

Neni 18

Roli dhe përgjegjësitë e Komitetit të Kontrollit

1. Detyrat e Komitetit të Kontrollit përfshijnë:

a) kontrollin dhe mbikëqyrjen e procedurave kontabël dhe kontroleve të brendshme të Bankës Shqiptare të Zhvillimit, duke siguruar

përputhshmërinë me legjislacionin dhe standardet, si dhe mbikëqyrjen e zbatimit të këtyre procedurave dhe kontrollin e llogarive e të regjistrave përkatës;

b) rishikimin e raporteve të kontrollit të brendshëm dhe monitorimin e adresimit të rekomandimeve, që burojnë nga këto raporte;

c) sigurimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret në fuqi, si dhe raportimin e gjetjeve dhe rekomandimeve të Këshillit Mbikëqyrës;

ç) propozimin për audituesin ligjor dhe realizimin e komunikimit ndërmjet tij dhe kontrollit të brendshëm;

d) dhënien e mendimeve për Këshillin Mbikëqyrës për çështjet për të cilat është kërkuar një mendim;

dh) dhënien e rekomandimeve për veprime Këshillit Mbikëqyrës lidhur me raportet financiare dhe pasqyrat financiare.

2. Kompetencat e Komitetit të Kontrollit detajohen në statutin e Bankës Shqiptare të Zhvillimit.

Neni 19

Kërkesat për përshtatshmëri dhe aftësi

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, të Këshillit të Administrimit e të Komitetit të Kontrollit, siç përcaktohet në statutin e Bankës Shqiptare të Zhvillimit, duhet të jenë persona që gëzojnë ndershmëri, pastërti morale dhe plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) kanë diplomë universitare ose pasuniversitare në fushat e financës, të ekonomisë ose të drejtësisë;

b) kanë përvojë profesionale në çështje financiare dhe bankare;

c) kanë të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) vjet përvojë profesionale në fushën specifike, sipas shkronjës “a” të këtij neni, duke përfshirë të paktën 5 (pesë) vjet në pozicione drejtuese në fushat e financës, të shërbimeve këshilluese ose të zhvillimit ekonomik;

ç) nuk janë nën hetim apo në proces gjyqësor penal dhe nuk kanë qenë të dënuar me vendim gjykatë për vepra penale të lidhura me pasurinë, krimin ekonomik ose shkelje, që lidhen me shoqëritë tregtare, përfshirë skema mashtruese ose piramidale të huamarrjes, pastrim parash ose financim të terrorizmit;

d) nuk kanë qenë të angazhuar ose të lidhur me humbje financiare të shkaktuara nga mashtrimi, paaftësia ose keqmenaxhimi në ofrimin e



shërbimeve financiare apo në menaxhimin e shoqërive të tjera;

dh)nuk mbajnë funksion drejtues në shërbimin publik apo funksion politik;

e) plotësojnë kriteret e tjera të përcaktuara në statut.

KREU III KONTABILITETI DHE AUDITIMI I PASQYRAVE FINANCIARE

Neni 20 **Kontabiliteti dhe llogaritë vjetore**

1. Banka Shqiptare e Zhvillimit mban të dhënat kontabël të saj në përputhje me legjislacionin që rregullon auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar në Republikën e Shqipërisë.

2. Praktikrat kontabël të Bankës Shqiptare të Zhvillimit udhëhiqen nga këto parime:

a) sigurimi i transparencës dhe i saktësisë në regjistrimin e aktiviteteve ekonomike;

b) përdorimi i standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe të praktikave më të mira;

c) përgatitja dhe dorëzimi i pasqyrave financiare vjetore në përputhje me afatet ligjore dhe format e parashikuara;

ç) mbajtja e një ndarjeje të qartë të llogarive, të të dhënave e të regjistrimeve financiare, si dhe të sistemeve të raportimit për aktivitetet promovuese dhe ato tregtare.

Neni 21 **Auditimi i pasqyrave financiare**

Pasqyrat financiare të Bankës Shqiptare të Zhvillimit auditohen në përputhje me auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor e të kontabilistit të miratuar në Republikën e Shqipërisë dhe praktikrat më të mira ndërkombëtare. Procesi i auditimit:

a) kryhet nga një auditor ligjor i pavarur ose një shoqëri audituese e licencuar;

b) siguron saktësinë, besueshmërinë dhe integritetin e raporteve financiare;

c) siguron garantimin e përputhshmërisë me kërkesat ligjore dhe rregullatore.

KREU IV MBIKËQYRJA DHE RAPORTIMI

Neni 22 **Marrëdhënia me Bankën e Shqipërisë**

1. Aktiviteti i mbledhjes së produkteve të kursimit nëpërmjet një entiteti të veçantë të Postës Shqiptare sh.a., mbikëqyret nga Banka e Shqipërisë. Entiteti i veçantë i Postës Shqiptare sh.a. nuk është subjekt licencimi.

2. Banka Shqiptare e Zhvillimit raporton te Banka e Shqipërisë për qëllime statistikore dhe për regjistrin e kredive.

3. Banka e Shqipërisë përcakton metodologjinë e mbikëqyrjes së aktivitetit të mbledhjes së produkteve të kursimit, si dhe të raportimit statistikor.

4. Banka e Shqipërisë dhe Banka Shqiptare e Zhvillimit lidhin një marrëveshje për mënyrën e menaxhimit të llogarive që hap banka pranë saj.

Neni 23 **Raportimi**

1. Banka Shqiptare e Zhvillimit, nëpërmjet ministrit përgjegjës sipas këtij ligji, paraqet raport vjetor të aktivitetit në Këshillin e Ministrave.

2. Raporti vjetor sipas këtij neni i paraqitet për njohje Komisionit Parlamentar përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Neni 24 **Transparenca dhe publikimi i të dhënave**

1. Banka Shqiptare e Zhvillimit siguron transparencë në veprimtarinë e saj, duke publikuar rregullisht të dhëna për aktivitetin financiar, performancën dhe ndikimin e saj në zhvillimin ekonomik.

2. Banka Shqiptare e Zhvillimit publikon periodikisht raporte financiare dhe statistika në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit e raportimit financiar.

3. Informacioni për produktet e kursimit, kushtet e tyre, si dhe normat e interesit është i aksesueshëm për publikun dhe shpërndahet nëpërmjet kanaleve të përcaktuara nga Banka Shqiptare e Zhvillimit, përfshirë faqen zyrtare të saj.



4. Banka Shqiptare e Zhvillimit respekton parimin e konfidencialitetit të të dhënave të klientëve, duke siguruar mbrojtjen dhe trajtimin e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

5. Këshilli Mbikëqyrës përcakton rregulla dhe procedura për transparencën dhe publikimin e të dhënave, me qëllim forcimin e besueshmërisë dhe llogaridhënies publike.

Neni 25

Kuadri ligjor i zbatueshëm

1. Dispozitat e ligjit që rregullon shoqëritë tregtare dhe të ligjit që rregullon regjistrimin e biznesit në Republikën e Shqipërisë janë të zbatueshme përveç atyre që lidhen me kompetencat e organeve të vendimmarrjes e të drejtimit të Bankës Shqiptare të Zhvillimit, kontributin dhe shlyerjen e kapitalit në shoqëritë aksionare, si dhe çështjet e tjera që janë përjashtuar shprehimisht nga ky ligj.

2. Dispozitat e ligjit që rregullon huamarrjen shtetërore nuk zbatohen për garancinë shtetërore, sipas përcaktimit të shkronjës “b”, të nenit 8 të këtij ligji.

3. Banka Shqiptare e Zhvillimit zbaton dispozitat e legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

4. Banka Shqiptare e Zhvillimit nuk është subjekt i procedurave të falimentimit. Ky proces rregullohet me ligj të posaçëm.

KREU V**DISPOZITA TË FUNDIT**

Neni 26

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të miratojë brenda 9 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji aktet nënligjore në zbatim të neneve 6, pikat 1 dhe 4, 7, pika 6, dhe 9, pika 1, të këtij ligji.

2. Ngarkohen ministri përgjegjës për financat dhe ministri përgjegjës për ekonominë të miratojnë urdhrin e përbashkët, sipas shkronjës “b”, të nenit 8 të këtij ligji, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 27

Dispozitë e fundit

Ministria, në cilësinë e aksionarit, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, ndjek procedurat e nevojshme për:

a) miratimin e statutit;

b) regjistrimin e Bankës Shqiptare të Zhvillimit në regjistrin tregtar;

c) sigurimin e gatishmërisë operacionale, përfshirë zgjedhjen e organeve drejtuese të Bankës Shqiptare të Zhvillimit.

Neni 28

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 17.3.2025.

Shpallur me dekretin nr. 109, datë 8.4.2025, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET**Nr. 109, datë 8.4.2025****PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 23/2025, “Për Bankën Shqiptare të Zhvillimit”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**



LIGJ
Nr. 24/2025

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 75/2019, “PËR RININË”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 75/2019, “Për rininë”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3 bëhen këto shtesa:

1. Pas shkronjës “b” shtohet shkronja “b/1” me këtë përmbajtje:

“b/1) “Grup joformal rinor” është grupimi i të rinjve, që ndajnë qëllime dhe vlera të përbashkëta, që nuk është regjistruar si person juridik, në përputhje me legjislacionin në fuqi, përfaqësohet nga anëtarët e tij dhe vepron me qëllim mbrojtjen dhe zhvillimin e interesave të të rinjve dhe zhvillimin e komunitetit vendor.”.

2. Pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “ç/1” me këtë përmbajtje:

“ç/1) “Qendra rinore” është personi juridik, që ofron infrastrukturën rinore për zhvillimin nga organizatat rinore, organizatat për të rinjtë, grupet joformale rinore dhe të rinjve, të aktiviteteve dhe veprimtarive rinore, programeve të edukimit joformal, aktiviteteve të informimit, mentorimit dhe trajnimit të të rinjve dhe punës rinore.”.

3. Pas shkronjës “f” shtohet shkronja “g” me këtë përmbajtje:

“g) “Të rinj JPAFP” janë të rinjtë jo në punësim, arsim ose formim profesional.”.

Neni 2

Pas shkronjës “ç” të pikës 1 të nenit 4 shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:

“d) parimin e gjithëpërfshirjes, ku politikat rinore garantojnë pjesëmarrjen efektive dhe të barabartë në

të gjitha sferat e jetës, për të rinjtë që u përkasin grupeve të marginalizuara, të rinjtë me nevoja të veçanta, të rinjtë me akses të kufizuar në shërbime dhe burime dhe të rinjtë JPAFP.”.

Neni 3

Shkronja “d” e nenit 5 ndryshohet si më poshtë:

“d) monitoron zbatimin e standardeve të funksionimit e të dhënies së shërbimeve nga qendrat rinore;”.

Neni 4

Në shkronjën “f” të pikës 2 të nenit 8 pas fjalëve “organizatat rinore” shtohen fjalët “grupet joformale rinore, këshillat rinorë vendorë”.

Neni 5

Në nenin 9 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:

“a) jep mendim për politikat prioritare, buxhetin dhe veprimtaritë në fushën e rinisë;”.

b) Pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:

“d) jep mendimin për politikat dhe çështjet e tjera me ndikim mbi të rinjtë, sipas kërkesës së ministrit përgjegjës për rininë.”.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Këshilli Kombëtar i Rinisë ka në përbërje 18 anëtarë, ku të paktën dy të tretat e anëtarëve përfaqësojnë të rinjtë. Këshilli, në përbërje të tij, siguron përfaqësim të drejtë dhe gjithëpërfshirës të grup-moshës rinore, pjesëmarrjen e të rinjve nga grupet e marginalizuara, të rinjve me nevoja të veçanta, të rinjve nga diaspora dhe respektimin e përfaqësimit të barabartë gjinor. Këshilli bashkëkryesohet nga ministri përgjegjës për rininë dhe njëri nga anëtarët e tij, që përfaqëson të rinjtë. Anëtarët e Këshillit emërohen me urdhër të ministrit përgjegjës për rininë.”.

3. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“2/1. Institucioni përgjegjës për rininë mbulon shpenzimet për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Rinisë.”.



4. Në pikën 3 pas fjalëve “procedurat e zgjedhjes” shtohen fjalët “dhe kompensimit të shpenzimeve”.

Neni 6

Në nenin 10 bëhen shtesat dhe ndryshimi i mëposhtëm:

1. Pas shkronjës “ç” të pikës 1 shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:

“d) jep mendim për politikën dhe çështjet e tjera vendore me ndikim mbi të rinjtë, sipas kërkesës së bashkisë.”.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Këshilli vendor i rinisë përbëhet nga një numër anëtarësh, që llogaritet në një të tretën e numrit në fuqi të anëtarëve të këshillit bashkiak, ku të paktën dy të tretat e anëtarëve përfaqësojnë të rinjtë. Këshilli bashkëkryesohet nga kryetari i bashkisë dhe njëri nga anëtarët e tij, që përfaqëson të rinjtë. Anëtarët e këshillit vendor të rinisë emërohen me urdhër të kryetarit të bashkisë.”.

3. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“2/1. Veprimtaria e këshillit vendor të rinisë financohet:

a) nga bashkia, bazuar në legjislacionin në fuqi;

b) nga institucioni përgjegjës për rininë, bazuar në këtë ligj dhe në aktet nënligjore të tij.”.

4. Në pikën 3 pas fjalëve “procedurat e përzgjedhjes” shtohen fjalët “dhe kompensimit të shpenzimeve”.

Neni 7

Shkronja “c” e pikës 2 të nenit 11 ndryshohet si më poshtë:

“c) të paktën 70 për qind e anëtarëve, në rastin e organizatave me anëtarësi, dhe të paktën dy të tretat e bordit të drejtorëve, në rastin e organizatave pa anëtarësi, të jenë të rinj.”.

Neni 8

Pas nenit 13 shtohet neni 13/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 13/1

Grupet joformale rinore

1. Grupet joformale rinore janë grupimet e organizuara të të rinjve, që ndajnë qëllime dhe vlera

të përbashkëta, zhvillojnë veprimtari, që nuk synojnë fitimin dhe nuk janë të regjistruar si persona juridikë, në bazë të legjislacionit në fuqi.

2. Grupet joformale rinore përmbushin këto kritere:

a) përbëhen nga të paktën 4 të rinj me shtetësi shqiptare dhe vendbanim në të njëjtën bashki;

b) caktojnë përmes një akti noterial një koordinator mes anëtarëve të grupit, që është në moshë madhore dhe përfaqëson grupin në marrëdhënie me të tretët;

c) ndërmarrin veprimtari dhe aktivitete, që adresojnë çështje dhe problematika në komunitetin e tyre vendor ose që synojnë mbrojtjen dhe zhvillimin e interesave të të rinjve.

3. Regjistrimi në bazën e të dhënave për rininë, sipas nenit 18 të këtij ligji, bëhet me kërkesë të koordinators të grupit joformal.

4. Grupet joformale rinore mund të përfitojnë financime nga organet e pushtetit qendror nëpërmjet fondit të dedikuar për rininë nga bashkitë, si dhe nga burime të tjera të ligjshme.”.

Neni 9

Pas nenit 14 shtohen nenet 14/1 dhe 14/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 14/1

Punonjësi rinor

1. Punonjës rinor është personi i angazhuar për të kryer punën rinore.

2. Punonjësi rinor mbështet dhe udhëzon të rinjtë, në grupe ose individualisht, në fusha të ndryshme dhe me interes për ta, duke mbështetur zhvillimin e tyre personal dhe shoqëror.

3. Punonjësi rinor punësohet dhe angazhohet si vullnetar pranë institucioneve publike dhe jopublike, që punojnë me të rinjtë pranë organizatave rinore dhe për të rinjtë pranë qendrave rinore dhe hapësirave rinore.

4. Regjistrimi në bazën e të dhënave për rininë, sipas nenit 18, të këtij ligji, bëhet me kërkesë të punonjësit rinor.

5. Institucioni përgjegjës për rininë mbështet ofrimin e programeve për formimin profesional të punonjësve rinorë dhe veprimtaritë për ngritjen e kapaciteteve dhe zhvillimin e vazhduar profesional të punonjësve rinorë.



6. Kriteret dhe procedurat e përfitimit të kualifikimit profesional të punonjësve rinorë miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për rininë dhe të ministrit përgjegjës për arsimin profesional.

Neni 14/2

Programi kombëtar i praktikave të punës

1. Programi kombëtar i praktikave të punës mbështet të rinjtë e diplomuar, me një përvojë kualifikuese profesionale në institucionet e administratës shtetërore dhe në institucionet e tjera publike.

2. Të rinjtë pjesëmarrës në program mbështeten gjatë zhvillimit të praktikës përmes mbikëqyrjes, trajnimit dhe trajtimit ushqimor dhe, pas përfundimit të praktikës, të rinjtë me vlerësimin më të lartë do të punësohen përmes kontratave të përkohshme të punës.

3. Programi kombëtar i praktikave të punës realizohet në bazë të thirrjeve vjetore dhe koordinohet nga ministri përgjegjës për rininë.

4. Këshilli i Ministrave miraton programin kombëtar të praktikave të punës në administratën shtetërore dhe në institucionet e tjera publike, duke përcaktuar rregullat për organizimin e programit dhe mbështetjes së të rinjve praktikantë.”

Neni 10

Në nenin 15 bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 3 pas fjalëve “organizatave rinore dhe/ose për të rinjtë” shtohen fjalët “bashkive, grupeve joformale rinore dhe këshillave rinorë vendorë”.

2. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Komisioni i vlerësimit ngrihet me qëllim vlerësimin e kërkesave për mbështetje përmes fondeve grant të buxhetit të shtetit, të dedikuara për rininë, të paraqitura nga organizatat rinore dhe për të rinjtë, bashkitë, grupet joformale rinore dhe këshillat rinorë vendorë. Rregullat për organizimin, funksionimin dhe përbërjen e komisionit të vlerësimit, si dhe kriteret, procedurat e përzgjedhjes dhe shpërblimit të anëtarëve të tij përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 11

Në nenin 16 bëhen shtesat dhe ndryshimi i mëposhtëm:

1. Në pikën 1 bëhen këto shtesa:

a) Në fund të shkronjës “b” shtohen fjalët “grupeve joformale rinore dhe këshillave rinorë vendorë”.

b) Pas shkronjës “b” shtohet shkronja “b/1” me këtë përmbajtje:

“b/1) financimin e programit të talenteve rinore”.

2. Në pikën 2 fjalët “Projektet e ndërtimit ose rikonstruksionit të objekteve publike dhe infrastrukturës rinore paraqiten dhe miratohen në përputhje me procedurat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi” zëvendësohen me fjalët “Projektet e ndërtimit ose të rikonstruksionit të objekteve publike dhe infrastrukturës rinore, sipas shkronjës a të pikës 1 të këtij neni, paraqiten dhe vlerësohen në përputhje me procedurat e parashikuara nga ky ligj dhe aktet nënligjore të tij”.

Neni 12

Pas nenit 16 shtohet neni 16/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 16/1

Programi i talenteve rinore

1. Programi i talenteve rinore mbështet të rinjtë në kultivimin dhe promovimin e talentit të tyre në fushat e artit, kulturës, edukimit, shkencës, teknologjisë dhe sportit, përmes mbulimit të kostove të pjesëmarrjes në kompeticionet dhe veprimtaritë zyrtare ndërkombëtare dhe dhënies së shpërblimit financiar, bazuar në vlerësimin e në rezultatet e arritura nga të rinjtë në kompeticionet dhe veprimtaritë zyrtare ndërkombëtare.

2. Rregullat për organizimin e programit, kriteret, mënyra e mbështetjes dhe masa e shpërblimit financiar për të rinjtë miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 13

Pas nenit 17 shtohet neni 17/1 me këtë përmbajtje:



“Neni 17/1
Qendrat rinore

1. Qendrat rinore krijohen si persona juridikë, që ofrojnë infrastrukturën rinore për zhvillimin, nga organizatat rinore, organizatat për të rinjtë, grupet joformale rinore dhe të rinjve, të aktiviteteve dhe veprimtarive rinore, programeve të edukimit joformal, aktiviteteve të informimit, mentorimit dhe trajnimit të të rinjve dhe punës rinore.

2. Qendrat rinore organizohen, sipas rastit, si më poshtë:

a) qendra rinore publike krijohet dhe funksionon si person juridik, i krijuar nga bashkia, që ka pronësinë mbi infrastrukturën rinore, që ofron qendra. Krijimi dhe rregullat për organizmin dhe funksionimin e qendrës rinore publike miratohen nga këshilli bashkiak;

b) qendra rinore e përbashkët krijohet dhe funksionon si person juridik, i ndarë nga palët, bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit të lidhur ndërmjet bashkisë, që ka pronësinë mbi infrastrukturën rinore që ofron qendra, dhe një ose më shumë organizatave rinore dhe organizatave për të rinj, që kryejnë veprimtarinë në territorin e bashkisë. Marrëveshja e bashkëpunimit përcakton rregullat për krijimin, organizimin, funksionimin, kohëzgjatjen dhe financimin e qendrës rinore të përbashkët dhe miratohet nga këshilli bashkiak;

c) qendra rinore jopublike krijohet si person juridik privat, fitimprurës ose jofitimprurës, që ofron infrastrukturën rinore dhe kryen veprimtarinë në përputhje me parashikimet e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi.

3. Bashkitë mund të lidhin marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet tyre dhe të tretëve për krijimin e qendrave rinore, që do t’u shërbejnë të rinjve të bashkive të tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi për vetëqeverisjen vendore.

4. Qendrat rinore mbështeten dhe financohen përmes kontributeve të themeluesve, donacioneve, sponsorizimeve dhe projekteve, si dhe nga të ardhurat e krijuara prej tyre.

5. Veprimtaria dhe aktivitetet e qendrave rinore përgatiten dhe zbatohen nga punonjësit rinorë, sipas përcaktimeve të nenit 14/1 të këtij ligji.

6. Qendrat rinore, për realizimin e veprimtarisë së tyre, bashkëpunojnë me strukturat administrative për çështjet e rinisë në bashki, institucionin

përgjegjës për rininë, këshillat vendorë rinorë dhe komunitetin rinor të bashkisë.

7. Roli, struktura dhe standardet bazë të cilësisë së qendrave rinore përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për rininë dhe të ministrit përgjegjës për çështjet vendore dhe zbatohen për të gjitha format e qendrave rinore.”

Neni 14

Në shkronjën “a” të pikës 2 të nenit 18 pas fjalëve “në vend dhe në diasporë” shtohen fjalët “grupet joformale rinore, punonjësit rinorë”.

Neni 15

Kudo në tekstin e ligjit fjalët “njësitë e vetëqeverisjes vendore” zëvendësohen me fjalën “bashkitë”.

Neni 16

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 17.3.2025.

Shpallur me dekretin nr. 108, datë 7.4.2025, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET

Nr. 108, datë 7.4.2025

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 24/2025, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 75/2019, ‘Për rininë’”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

**URDHËR**
Nr. 59, datë 8.4.2025**PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE**

Në mbështetje të ligjit nr. 61/2023, “Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së *Cannabis*-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale”, neneve 22, pika 3, 28 dhe 29 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të institucionit të Agjencisë Kombëtare të Kontrollit të *Cannabis*-it, koordinatorit pranë drejtorit të përgjithshëm, znj. Marcela Shahini, për shkak të mungesës me arsye të titullarit.

2. Delegimi i kompetencave përfshin vetëm fushën e veprimtarisë administrative të institucionit.

3. Kompetencat e drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë do të ushtrohen për periudhën nga data 9.4.2025 deri më datë 14.4.2025.

4. Këto kompetenca do të ushtrohen për periudhën e sipërcituar, me ndërprerjen vetëm në rastet kur kompetencat rimerren nga titullari i institucionit.

5. Për vendimmarrje të një rëndësie të veçantë apo çështje të caktuara, znj. Marcela Shahini duhet të marrë miratimin paraprak nga drejtori i përgjithshëm nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik.

6. Për veprimet e kryera në zbatim të këtij urdhri, koordinatori pranë drejtorit të përgjithshëm do të ruajë kopje të kartelave shoqëruese të praktikave shkresore të iniciuara, apo të përfunduara prej tij, së bashku me afatet e përcaktuara dhe ecurinë e mbarëvajtjes së çështjeve, dhe do t’ia bëjë të ditura titullarit me rikthimin e tij në detyrë.

7. Ngarkohet znj. Marcela Shahini, koordinator pranë drejtorit të përgjithshëm, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Linda Pustina

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE
TË NJERIUT**SEKSIONI I TRETË****VENDIM****Kërkesa nr. 1541/13**
Jorgo QIQI
kundër Shqipërisë

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 21 janar 2025, si Komitet i përbërë nga:

Latif Hüseyinov, *kryetar*,

Darian Pavli,

Úna Ní Raifeartaigh, *gjyqtarë*,

dhe Olga Chernishova, *zëvendëskancelare e Seksionit*,

Duke pasur parasysh:

kërkesën (nr. 1541/13) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë, sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (Konventa) më 29 dhjetor 2012, nga shtetasi shqiptar dhe grek z. Jorgo Qiqi (kërkuesi), i lindur në vitin 1949, me banim në Tiranë dhe i përfaqësuar nga z. F. Caka, avokat i licencuar në Tiranë;

vendimin për të njoftuar për kërkesën qeverinë e Shqipërisë (qeveria) të përfaqësuar nga Agjentja asokohe znj. A. Hiçka;

parashtrimet e palëve;

njoftimin e qeverisë greke për të drejtën e saj për të ndërhyrë në proces (neni 36 § 1 i Konventës dhe Rregullore 44 e Rregullores së Gjykatës) dhe vendimin e tyre për të mos ushtruar të drejtën e tyre për ta bërë këtë gjë;

Pas diskutimit, vendosi si më poshtë:

OBJEKTI I ÇËSHTJES

1. Kërkesa ka të bëjë me një seancë *in absentia* përpara Gjykatës së Lartë të Shqipërisë. Gjithashtu ka të bëjë me prishjen e një ndërtese të ndërtuar nga kërkuesi në territorin e një spitali dhe rrëzimin e pretendimit të kërkuesit për kompensim.

2. Në vitin 1990, kërkuesi ndërtoi një ndërtesë në territorin e Spitalit nr. 1 në Tiranë bazuar në miratimin e drejtorit të spitalit asokohe, dhe më pas e përdori ndërtesën për qebaptore.

3. Më 6 gusht 1992, Gjykata e Rrethit Tiranë gjeti që ndërtesa ishte ndërtuar pa leje ndërtimi dhe në një



proces gjyqësor të filluar nga Qendra Spitalore Universitare Tiranë urdhëroi kërkuesin për prishjen e tij. Më 15 tetor 1992, Gjykata e Apelit Tiranë ndryshoi vendimin e Gjykatës së Rrethit *dhe pushoi gjykimin e çështjes*, duke gjetur që kërkuesi kishte ushtruar aktivitetin e restorantit në përputhje me rregullimet përkatëse dhe nuk kishte arsye për të ndërprerë atë aktivitet.

4. Në vitin 1994, ndërtesa u regjistrua në Zyrën e Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme. Në vitin 1996, kërkuesi nënshkroi një kontratë me Bashkinë e Tiranës, sipas së cilës bleu një sipërfaqe toke 189 m² mbi të cilën ishte ndërtuar ndërtesa. Trualli u regjistrua në Zyrën e Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme.

5. Në vitin 1999, Policia e Ndërtimit Tiranë urdhëroi prishjen e ndërtesës. Në vitin 2000, ajo pezulloi prishjen.

6. Në vitin 2001, Policia e Ndërtimit urdhëroi përsëri prishjen e ndërtesës me arsyetimin që ndodhej në një truall shtet. Më 28 janar 2002, Gjykata e Rrethit Tiranë e shpalli urdhrin të pavlefshëm në procesin gjyqësor të filluar nga kërkuesi. Më 11 qershor 2002, Gjykata e Apelit Tiranë la në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit ku u shpreh që kërkuesi kishte blerë truallin dhe, sa kohë që titulli i pronësisë mbi truallin nuk ishte objekt konflikti, nuk kishte shkak ligjor për prishjen e ndërtesës. Qendra Spitalore Universitare Tiranë depozitoi një ankim në Gjykatën e Lartë. Më 27 janar 2024, Gjykata e Lartë prishi vendimin e gjykatave më të ulëta me arsyetimin që kërkuesi nuk kishte shteruar një mjet administrativ. Kërkuesi depozitoi një ankim në Gjykatën Kushtetuese, ku pretendoi se nuk ishte njoftuar për ankimin e Qendrës Spitalore Universitare në Gjykatën e Lartë dhe prandaj nuk kishte marrë pjesë në seancën përpara Gjykatës së Lartë. Më 20 korrik 2012, Gjykata Kushtetuese rrëzoi ankimin e kërkuesit duke gjetur që kërkuesi nuk kishte treguar “interes për të kundërshtuar” vendimin e Gjykatës së Lartë, bazuar në faktin që urdhri i prishjes, i vitit 2001, i Policisë së Ndërtimit, ishte bërë i diskutueshëm për shkak të mos ekzekutimit, dhe ishte zëvendësuar me urdhrin e prishjes të vitit 2005 (shihni më poshtë), i cili ishte objekt i proceseve gjyqësore në vijim.

7. Më 16 mars 2005, Policia e Ndërtimit Tiranë konstatoi se kërkuesi e kishte ndërtuar ndërtesën pa leje ndërtimi. Kërkuesi e kundërshtoi pa sukses këtë gjetje përpara Policisë së Ndërtimit. Më 19 mars

2005, Policia e Ndërtimit nxori një urdhër të ri prishjeje, i cili u ekzekutua më 22 maj 2006. Kërkuesi filloi proces gjyqësor për kompensimin e dëmit të pësuar për shkak të prishjes dhe fitimit të humbur. Më 17 prill 2007, Gjykata e Rrethit Tiranë pranoi pjesërisht pretendimet e kërkuesit, duke urdhëruar Policinë e Ndërtimit t'i paguante kërkuesit 9,828,000 lekë. Policia e Ndërtimit bëri ankim, me arsyetimin se ndërtimi ishte kryer pa leje ndërtimi; prishja kishte qenë në përputhje me kërkesën e Ministrisë së Shëndetësisë; dhe vlerësimi i vlerës së ndërtesës, që ishte prishur, kishte qenë i gabuar. Më 8 prill 2008, Gjykata e Apelit Tiranë rrëzoi ankimin dhe la në fuqi vendimin.

8. Më 20 nëntor 2012, Gjykata e Lartë, në rekursin e paraqitur nga Policia e Ndërtimit, rrëzoi pretendimet e kërkuesit. Ajo gjeti se kërkuesi kishte ndërtuar ndërtesën në territorin e spitalit pa leje ndërtimi nga një organ i autorizuar, në kundërshtim me dekretin nr. 5747, të Presidiumit të Kuvendit Popullor, të 29 qershorit 1978 dhe e kishte shfrytëzuar atë për një kohë të gjatë. Veprimet e Policisë së Ndërtimit për prishjen e ndërtimit pa leje nuk kanë qenë të paligjshme dhe nuk duhet të jepet dëmshpërblim.

9. Kërkuesi filloi proces gjyqësor edhe kundër Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, e cila në vitet 2008 dhe 2009 kishte refuzuar kërkesat e tij për vërtetimin dhe regjistrimin e pronësisë së tij mbi truallin, në të cilin dikur ndodhej ndërtesa e kërkuesit. Vendimi i Gjykatës së Rrethit Tiranë, të datës 19 korrik 2012, i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë më 7 tetor 2013, rrëzoi pretendimet e tij. Më 27 korrik 2020, Gjykata e Lartë refuzoi rekursin e kërkuesit si të papranueshëm.

VLERËSIMI I GJYKATËS

A. Shkelja e pretenduar e paragrafit 1, të nenit 6 të Konventës

10. Kërkuesi u ankua që nuk ishte njoftuar për ankimin e Qendrës Spitalore Universitare në Gjykatën e Lartë dhe prandaj nuk kishte marrë pjesë në seancën përpara Gjykatës së Lartë, më 27 janar 2004.

11. Gjykata sjell në kujtesë që për të zbatuar nenin 6, rezultati i procesi gjyqësor duhet të jetë drejtpërdrejt vendimtar për të drejtën civile në fjalë (shihni *Frydlender kundër Francës* [DHM], nr. 30979/96, § 27, GJEDNJ 2000-VII). Proceset gjyqësore për pyetjen nëse një kërkesë ose ankesë është apo jo e pranueshme në aspektin procedural



nuk janë procese ku vendoset mbi një mosmarrëveshje për të drejtat dhe detyrimet civile. Gjykata vëren se Gjykata Kushtetuese, në lidhje me vendimin e Gjykatës së Lartë, të vitit 2004, gjeti se objekti i procesit që kundërshtonte urdhrin e prishjes të vitit 2001 ishte bërë i diskutueshëm pasi ai urdhrë për prishje nuk ishte zbatuar dhe më vonë ishte zëvendësuar me urdhrin e prishjes të vitit 2005. Për më tepër, në vendimin e saj të datës 27 janar 2004, Gjykata e Lartë rrëzoi vendimet e gjykatave më të ulëta, duke vërejtur se kërkuesi nuk kishte shtetur një mjet juridik administrativ. Prandaj, objekti kufizohej në çështjen e pranueshmërisë së padisë së kërkuarit. Proceset gjyqësore në fjalë nuk përfshinin vendimin mbi të drejtat dhe detyrimet civile të kërkuarit dhe nuk zbatoheshin neni 6 (shihni, ndër të tjera, *Nicholas kundër Qipros* (ven.), nr. 37371/97, 14 mars 2000; dhe *Neshev kundër Bullgarisë* (ven.), nr. 40897/98, 13 mars 2003).

12. Prandaj, ky ankim është i papajtueshëm *ratione materiae* me dispozitat e Konventës sipas kuptimit të nenit 35 § 3 (a) dhe duhet të refuzohet në përputhje me nenin 35 § 4.

B. Shkelja e pretenduar e nenit 1, të Protokollit nr. 1

13. Kërkuesi u ankua sipas nenit 1, të Protokollit nr. 1 të Konventës, se ishte shkelur e drejta e tij për gëzimin paqësor të pasurisë së tij. Ai theksoi se ankimi i tij kishte të bënte me ndërtesën që kishte ndërtuar dhe jo me truallin e tokës.

14. Gjykata kujton se neni 1, i Protokollit nr. 1, nuk garanton të drejtën për të fituar pronë. Kjo dispozitë nuk bën gjë tjetër veçse sanksionon të drejtën e secilit për gëzimin paqësor të pasurisë “së tij”, dhe për rrjedhojë ajo zbatohet vetëm për pasuritë ekzistuese të një personi. Nëse një person ka në fakt një pronë dhe konsiderohet pronar i saj për të gjitha qëllimet ligjore, ai ose ajo mund të thuhet se ka një “pasuri” sipas kuptimit të nenit 1, të Protokollit nr. 1. “Pasuritë” mund të jenë, gjithashtu, pasuri, duke përfshirë pretendimet, në lidhje me të cilat kërkuesi mund të pretendojë se ai ose ajo ka të paktën një “pritshmëri legjitime” për të siguruar gëzimin efektiv të të drejtës së pronës. Në të kundërt, shpresa për njohjen e një të drejte të pronës, e cila ka qenë e pamundur të ushtrohej në mënyrë efektive, nuk mund të konsiderohet “pasuri” sipas kuptimit të nenit 1, të Protokollit nr. 1. Një “pritshmëri legjitime” duhet të jetë me natyrë më konkrete se sa thjesht një shpresë dhe duhet të

bazohet në një dispozitë ligjore ose një akt ligjor siç është një vendim gjykate. Një person që ankohet për shkelje të së drejtës së tij të pronës së pari duhet të tregojë që ekziston kjo e drejtë (shihni *Zbigalev kundër Rusisë*, nr. 54891/00, § 131, 6 korrik 2006, me referenca të mëtejshme).

15. Që nga viti 1992 kishte pasur një mosmarrëveshje mbi të drejtën e kërkuarit për ndërtesën, të cilën ai e kishte ndërtuar në territorin e spitalit dhe e kishte përdorur për qëllime tregtare, duke rezultuar në padi të përsëritura nga ana e Qendrës Spitalore Universitare Tiranë dhe Policisë së Ndërtimit për prishjen e ndërtesës. Në vendimin e datës 20 nëntor 2012, Gjykata e Lartë gjeti që kërkuesi e kishte ndërtuar ndërtesën në territorin e spitalit pa leje ndërtimi të lëshuar nga një organ i autorizuar, në kundërshtim me legjislacionin përkatës, që prishja nuk kishte qenë e paligjshme dhe që për rrjedhojë nuk duhej dhënë asnjë dëmshpërblim (shihni paragrafin 8 më lart). Gjykata nuk mund të mos vërejë se konstatimi që ndërtesa ishte një ndërtim pa leje, i ndërtuar pa leje ndërtimi ishte bërë fillimisht nga Gjykata e Rrethit Tiranë njëzet vjet më parë. Edhe pse ai vendim u prish në apel, vlerësimi i gjykatës së apelit lidhej me ligjshmërinë e veprimtarisë së restorantit të kërkuarit dhe jo me ligjshmërinë e ndërtimit (shihni paragrafin 3 më lart). Prandaj, ajo nuk mund të konsiderohet si bazë për të drejtat legjitime të kërkuarit mbi ndërtesën (krahasoni *Zela kundër Shqipërisë*, nr. 33164/11, § 78 *et seq.*, 11 qershor 2024).

16. Gjykata del në përfundimin se, për qëllimet e nenit 1, të Protokollit nr. 1, kërkuesi nuk mund të konsiderohet se ka pasur “pasuri ekzistuese” ose një pretendim që përbën një “pritshmëri legjitime” në kuptimin e jurisprudencës së Gjykatës (shihni, gjithashtu, *Kopecký kundër Sllovakisë* [DHM], 44912/98, §35, GJEDN], 2004-IX). Kërkuesi shpresonte të kishte një “pasuri” të tillë, që kishte një bazë tepër të pasaktë mbi të cilën të krijonte një pritshmëri legjitime të mbrojtur ligjërisht, që mund të përbënte “pasuri” sipas kuptimit të nenit 1, të Protokollit nr. 1.

17. Prandaj, ky ankim është, gjithashtu, i papajtueshëm *ratione materiae* me dispozitat e Konventës sipas kuptimit të nenit 35 § 3 (a) dhe duhet të refuzohet në përputhje me nenin 35 § 4.

**C. Shkelja e pretenduar e nenit 13 të Konventës**

18. Në fund, kërkuesi u ankua sipas nenit 13 të Konventës që ai nuk kishte pasur mjete efektive zgjidhjeje për ankimet e tij, në lidhje me shembjen e ndërtesës së tij, sepse nuk kishte marrë dëmshpërblim.

19. Duke pasur parasysh gjetjet e saj në paragrafin 17 më sipër, Gjykata gjen që kërkuesi nuk ka një pretendim të bazuar sipas nenit 13. Nga kjo vijon se edhe ky ankim është i papajtueshëm *ratione materiae* me dispozitat e Konventës, sipas kuptimit të nenit 35 § 3 (shihni, për shembull, *Gavella kundër Kroacisë* (ven.), nr. 33244/02, GJEDNJ 2006-XII (ekstrakte)) dhe duhet të refuzohet në përputhje me nenin 35 § 4 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata, unanimisht,
Shpall kërkesën të papranueshme.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 13 shkurt 2025.

Olga Chernishova
ZËVENDËSKANCELARE

Lotif Hüseyinov
KRYETAR

**GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE
TË NJERIUT****SEKSIONI I TRETË****VENDIM****Kërkesa nr. 1840/23
Marius Tafa
kundër Shqipërisë**

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 28 janar 2025, si Komitet i përbërë nga:

Lotif Hüseyinov, kryetar,

Darian Pavli,

Úna Ní Raifeartaigh, gjyqtarë,

dhe Olga Chernishova, zëvendëskancelare e Seksionit,

Duke pasur parasysh:

Kërkesën (nr. 1840/23) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (“Konventa”) më 4 janar 2023 nga shtetasi shqiptar z. Marius Tafa (“kërkuesi”), i lindur në vitin 1988, me banim në Peqin dhe i

përfaqësuar nga znj. E. Kanapari, avokate e licencuar në Tiranë;

Vendimin për të njoftuar Qeverinë e Shqipërisë (“Qeveria”) të përfaqësuar nga Agjenti Z.O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit, për ankimet në lidhje me të drejtën e kërkuesit për kohë të nevojshme për të përgatitur mbrojtjen e tij në procesin penal kundër tij dhe për të shpallur të papranueshme pjesën tjetër të kërkesës;

Parashtrimet e depozituara nga Qeveria e paditur dhe prapësimet e paraqitura nga kërkuesi;

Komentet e depozituara nga Res Publica që u pranuan për ndërhyrje nga kryetari i Seksionit;

Pas diskutimit, vendosi si më poshtë:

OBJEKTI I ÇËSHTJES

1. Çështja ka të bëjë me padrejtësinë e gjykimit penal të kërkuesit.

2. Gjykimi kundër kërkuesit për akuzën e vrasjes së një punonjësi policie dhe armëmbajtjes pa leje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan filloi më 2 shkurt 2011. Në këto procese kërkuesi u përfaqësua nga J.K., avokat i zgjedhur prej tij. Gjykata caktoi seancat çdo të mërkurë në orën 13:00. Megjithatë, avokati i kërkuesit nuk u paraqit në disa seanca.

3. Kur J.K. nuk u paraqit pa arsye në seancat e planifikuara në 23 shkurt dhe 23 dhe 30 mars 2011, gjykata i shtyu seancat. Kur J.K. nuk u paraqit pa arsye në seancën e mbajtur më 13 prill 2011, gjykata caktoi avokatin K.M. për të përfaqësuar kërkuesin dhe shtyu seancën për të njoftuar avokatin K.M. Megjithatë, në seancën e radhës të mbajtur më 20 prill 2011, avokati J.K. u paraqit dhe vazhdoi të mbrojtë kërkuesin dhe avokati K.M. u lirua nga detyra.

4. Kur J.K. sërish nuk u paraqit në seancën e caktuar në datën 27 prill 2011, gjykata caktoi avokatin Gj.Xh. për të mbrojtur kërkuesin dhe e shtyu seancën në mënyrë që avokati Gj.Xh. të kishte kohë për t’u përgatitur për mbrojtjen e kërkuesit. Në seancën e radhës të mbajtur më 4 maj 2011, avokati Gj.Xh. u paraqit dhe informoi gjykatën se ai kishte studiuar dosjen e çështjes dhe ishte gati të përfaqësonte kërkuesin.

5. Në seancat e mëtejshme kërkuesi u përfaqësua ose nga avokati J.K. kur ai paraqitej, ose në rast të mungesës së tij, nga avokati Gj.Xh.

6. Në seancën e mbajtur më 1 qershor 2011, avokati J.K. nuk u paraqit, dhe avokati Gj.Xh. u thirr menjëherë dhe përfaqësoi kërkuesin.



7. Në seancën e mbajtur më 26 tetor 2011, avokati J.K. kërkoi kohë shtesë për të përgatitur diskutimet përfundimtare dhe gjykata e shtyu seancën. Avokati J.K. kërkoi sërish më shumë kohë më 9 nëntor 2011 dhe seanca e caktuar për atë ditë u shty.

8. Në seancën e mbajtur më 21 dhjetor 2011, avokati J.K. lexoi diskutimet përfundimtare përpara gjykatës.

9. Më 11 janar 2012, gjykata e shpalli kërkuesin fajtor sipas akuzës dhe e dënoi atë me njëzet e tre vjet burgim. Ky vendim u la në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës më 11 korrik 2012 dhe nga Gjykata e Lartë më 17 mars 2022. Më 30 shtator 2022, Gjykata Kushtetuese rrëzoi ankimin kushtetues të kërkuesit.

VLERËSIMI I GJYKATËS

10. Kërkuesi u ankua sipas nenit 6 §§ 1 dhe 3 (b) të Konventës që avokatit të caktuar nga gjykata nuk i ishte dhënë koha e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e tij për seancën e mbajtur në Gjykatën e Rrethit Elbasan më 1 qershor 2011 dhe për paraqitjen e diskutimeve përfundimtare në emër të kërkuesit.

11. Gjykata vëren që avokati i zgjedhur nga kërkuesi në mënyrë të përsëritur nuk u paraqit, pa arsye, në seancat e planifikuara paraprakisht, edhe pse ai ishte në dijeni që seancat ishin planifikuar të zhvilloheshin çdo të mërkurë në orën 13:00. Këto rrethana, sipas Gjykatës, justifikuan caktimin e një avokati tjetër nga gjykata për kërkuesin. Gjykata ka vendosur tashmë që caktimi i më shumë se një avokati mbrojtës nuk është në vetvete në kundërshtim me Konventën dhe mund të përdoret në raste specifike në interes të drejtësisë (shihni Croissant kundër Gjermanisë, 25 shtator 1992, § 27, Seria A nr. 237-B).

12. Avokati Gj.Xh. u emërua për herë të parë më 27 prill 2011 dhe seanca e caktuar për atë ditë u shty në mënyrë që ai të mund të përgatitej për mbrojtjen e kërkuesit. Që në seancën e mbajtur më 4 maj 2011 avokati Gj.Xh. tha se ai kishte studiuar dosjen e çështjes dhe ishte i gatshëm të përfaqësonte kërkuesin. Prandaj, duke e parë procesin në tërësi, Gjykata vlerëson se avokati Gj.Xh. pati mundësinë të njëjhej me dosjen e çështjes dhe të përgatitej për mbrojtjen e kërkuesit përpara seancës së mbajtur më 1 qershor 2011.

13. Më tej avokati J.K. vazhdoi të përfaqësonte kërkuesin. Ai asnjëherë nuk ka kundërshtuar

përfaqësimin e kërkuesit nga avokati Gj.Xh. para gjykatës, dhe po kështu as kërkuesi.

14. Për sa i përket seancës përfundimtare dhe diskutimeve përfundimtare, Gjykata vëren se këto janë bërë nga avokati i zgjedhur i kërkuesit, J.K. Gjykata nuk ka asnjë element që të dyshojë për kohën e mjaftueshme që ai kishte për t'u përgatitur, pasi gjykata i kishte shtyrë dy herë seancat pikërisht për këtë qëllim.

15. Nisur nga rrethanat e mësipërme, Gjykata konstaton se të drejtat e kërkuesit për t'u mbrojtur, dhe, në veçanti, e drejta e tij për të pasur kohë të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes së tij, të garantuara sipas nenit 6 §§ 1 dhe 3 (b) ishin mbrojtur në mënyrën e duhur në procesin penal në fjalë.

16. Për rrjedhojë, kjo pjesë e kërkesës është haptazi e pabazuar dhe duhet të refuzohet në përputhje me nenin 35 §4 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata, unanimisht,
Shpall kërkesën të papranueshme.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 27 shkurt 2025.

Olga Chernishova
ZËVENDËSKANCELARE

Lutfi Hüseyinov
KRYETAR

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 16351/15
Edmond Peshkopia dhe Bardhyl Talipi
kundër Shqipërisë
(shih tabelën bashkëlidhur)

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 6 shkurt 2025 si një Komitet i përbërë nga:

Oddný Mjöll Arnardóttir, *kryetar*,

Úna Ní Raifeartaigh,

Mateja Đurović, *gjyqtarë*

dhe Viktoriya Maradudina, *zëvendëssekretare e*

Përkohshme e Seksionit,

Duke mbajtur në konsideratë kërkesën e mësipërme të paraqitur më 27 mars 2015,



Duke mbajtur në konsideratë parashtrimet e paraqitura nga Qeveria e paditur dhe parashtrimet e paraqitura nga kërkuesit si përgjigje,

Pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

FAKTET DHE PROCEDURA

Lista e kërkuesve paraqitet në tabelën bashkëlidhur.

Kërkuesit u përfaqësuan nga z. Xh. Sheta, një avokat i cili e ushtron ligjin në Tiranë.

Kërkuesi i parë ndërroi jetë më 29 gusht 2016, teksa procedurat ishin pezull në Gjykatë. Me anë të një letre të datës 4 korrik 2024, përfaqësuesi i z. Peshkopia informoi Gjykatën se trashëgimtarët e kërkuesit të parë dëshironin të vijonin procedurat në vendin e tij dhe se do të mbanin të njëjtin përfaqësues.

Ankesat e kërkuesve, sipas nenit 6 § 1 dhe nenit 13 të Konventës, në lidhje me mosekzekutimin e një vendimi të datës 12 nëntor 2013 të Gjykatës së Rrethit Fier (“vendimi 2013”) dhe pretendimin për mungesë të mjeteve vendëse për këtë aspekt, iu komunikuan Qeverisë shqiptare (“Qeveria”).

LIGJI

A. Në lidhje me kërkuesin e parë

Gjykata vëren se përfaqësuesi i trashëgimtarëve të kërkuesit të parë deklaroi se trashëgimtarët dëshironin të vijonin procedurat në emër të kërkuesit të parë, megjithatë ata nuk paraqitën në Gjykatë ndonjë formular mbi autoritetin.

Më 8 korrik, 10 shtator dhe 6 nëntor 2024, Gjykata informoi përfaqësuesin e kërkuesit të parë me anë të postës rekomande dhe me anë të Shërbimit të Komunikimit Elektronik të Gjykatës (eComms), se ai duhej të paraqiste formularët origjinalë të autoritetit për trashëgimtarët e kërkuesit të parë. Atij iu kërkua t’i kushtonte vëmendje kushteve të nenit 37 § 1 (a) të Konventës, ku parashikohej se Gjykata mund të çregjistronte një kërkesë nga lista e saj e çështjeve, në rastin kur

rrethanat çonin në përfundimin se kërkuesi nuk synonte që të ndiqte kërkesën. Edhe pse përfaqësuesi i kishte shkarkuar të gjitha letrat, nuk u dha asnjë përgjigje.

Mbështetur në sa më sipër dhe në mungesë të rrethanave të posaçme, në lidhje me respektimin e të drejtave të garantuara nga Konventa dhe Protokollet e saj, Gjykata, në përputhje me nenin 37 § 1 (a) të Konventës, gjykon se nuk është më e justifikueshme që të vijohet shqyrtimi i kërkesës në lidhje me kërkuesin e parë.

Në këtë mënyrë, pjesa e kërkesës që ka të bëjë me kërkuesin e parë duhet të çregjistrohet nga lista e çështjeve të Gjykatës.

B. Në lidhje me kërkuesin e dytë

Gjykata thekson se kërkuesi i dytë nuk ishte palë në procedurat në gjykatat vendëse, dhe të drejtat e tij nuk kishin qenë asnjëherë objekt i shqyrtimit në nivel të brendshëm, veçanërisht në procedurat që çuan në vendimin e vitit 2013, zbatimi i të cilit është në thelb të kërkesës konkrete. Për pasojë, ai nuk mund të pretendojë të jetë viktimë e shkeljes së pretenduar sipas interpretimit të nenit 34 të Konventës. Në vijim, kërkesa e paraqitur nga kërkuesi i dytë nuk është në pajtim *ratione personae* me parashikimet e Konventës dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35 §§ 3 dhe 4 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata, unanimisht,

Vendos të çregjistrojë kërkesën nga lista e saj e çështjeve për sa i përket kërkuesit të parë.

E shpall kërkesën të papranueshme për sa i përket kërkuesit të dytë.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 6 mars 2025.

Viktoriya Maradudina

ZËVENDËSSEKRETARE E
PËRKOHSHME

Oddný Mjöll
Arnardóttir
KRYETAR



SHTOJCË

Kërkesa me anë të së cilës paraqiten ankesa në mbështetje të nenit 6 § 1 të Konventës
(mosekzekutimi ose ekzekutim i vonuar i vendimeve të gjykatës)

Kërkesa nr. Data e paraqitjes	Emri i kërkueses Viti i lindjes	Emri dhe vendndodhja e përfaqësuesit	Vendimi përkatës vendas	Fillimi i periudhës së mosekzekutimit	Akordimi vendas (në euro)	Detaje të urdhrit të ekzekutimit	Ankesa të tjera sipas praktikës gjyqësore të konsoliduar
16351/15 27/03/2015	Edmond PESHKOPIA 1934 Ndërron jetë në vitin 2016 (kërkuesi i parë) Bardhyl TALIPI 1946 (kërkuesi i dytë)	Xhevdet Sheta Tiranë	Vendimi nr. 1729 i Gjykatës së Rrethit Fier, 12/11/2013	17/02/2014	Detyrim i Komisionit Vendor për Rivlerësimin e Akteve të Pronësisë Fier për të marrë një vendim administrativ në lidhje me ankesën se janë lëshuar një sërë aktesh të tjerë pronësie për persona të tjerë për të njëjtën tokë bujqësore	Urdhri i ekzekutimit i Gjykatës së Rrethit Fier nr. 517 i datës 17/02/2014.	Neni 13 – mungesa e mjetëve efektive për mosekzekutimin ose ekzekutimin e vonuar të vendimeve vendase

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 40224/18
Majlinda ZORBA
kundër Shqipërisë
(shih tabelën bashkëlidhur)

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
(Seksioni i Tretë), e mbledhur më 6 shkurt 2025, si
një Komitet i përbërë nga:

Oddný Mjöll Arnardóttir, *kryetar*,

Úna Ní Raifeartaigh,

Mateja Đurović, *gjyqtarë*

dhe Viktoriya Maradudina, *zëvendëssekretarë e*
Përkohshme e Seksionit,

Duke mbajtur në konsideratë kërkesën e
mësipërme të paraqitur më 21 gusht 2018,

Duke mbajtur në konsideratë deklaratën e
paraqitur nga Qeveria e paditur, me anë të së cilës i

kërkohet Gjykatës të çregjistrojë kërkesën nga lista e
çështjeve,

Pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

FAKTET DHE PROCEDURA

Detajet e kërkeses janë paraqitur në tabelën
bashkëlidhur.

Kërkuesja u përfaqësua nga z. P. Berxolli, i cili
jeton në Tiranë.

Ankesa e kërkeses, bërë në mbështetje të nenit
6 § 1 të Konventës, në lidhje me kohëzgjatjen e
tepërt të procedurave civile iu komunikua Qeverisë
shqiptare (“Qeveria”).

LIGJI

Pas negociatave të pasuksesshme për zgjidhje
miqësore, Qeveria informoi Gjykatën se
propozonte të bënte një deklaratë të njëanshme, me
synimin për të zgjidhur problematikat e ngritura në
çështje. Në vijim, Qeveria i kërkoi Gjykatës të
regjistronte kërkesën në mbështetje të nenit 37 të
Konventës. Shuma do të konvertohej në monedhën
e Shtetit të paditur në normën e zbatueshme në
datën e shlyerjes, dhe do të paguhej brenda tre
muajve nga data e njoftimit të vendimit të Gjykatës.
Në rastin e mospagimit të kësaj shume brenda
periudhës tremujore të përmendur më sipër,



Qeveria merrte përsipër të paguante interesin e thjeshtë ndaj shumës, nga përfundimi i asaj periudhe deri në shlyerjen e shumës, në normën e barasvlershme me normën marginale të huadhënies së Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mosshlyerjes plus tre pikë përqindjeje.

Pagesa do të përbënte zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

Kërkueses iu dërguan kushtet e deklaratës së njëanshme të Qeverisë disa javë përpara datës së këtij vendimi. Gjykata nuk ka marrë një përgjigje nga kërkuesja nëse ajo binte dakord me kushtet e deklaratës.

Gjykata thekson se neni 37 § 1 (c) i mundëson që ta çregjistrojë një çështje nga lista e saj, nëse:

“... për çdo arsye tjetër që, sipas Gjykatës, nuk justifikon vazhdimin e shqyrtimit të kërkesës.”

Në këtë mënyrë, ajo mund të çregjistrojë kërkesat në mbështetje të nenit 37 § 1 (c) sipas një deklaratë të njëanshme nga një Qeveri e paditur, edhe nëse kërkuesi dëshiron që të vijohet me shqyrtimin e çështjes (shih, veçanërisht, vendimin *Tabsin Acar kundër Turqisë* (kundërshtime paraprake) [DHM], nr. 2607/95, §§ 75-77, GJEDNJ 2003-VI).

Gjykata ka krijuar një praktikë gjyqësore të qartë dhe të gjerë në lidhje me ankesat që kanë të bëjnë me kohëzgjatjen e tepërt të procedurave civile (shih, për shembull, *Luli dhe të Tjerë kundër Shqipërisë*, nr.

64480/09 dhe 5 të tjerë, 1 prill 2010 dhe *Mishgjoni kundër Shqipërisë*, nr. 18381/05, 7 dhjetor 2010).

Duke iu referuar parashtrimeve në deklaratën e Qeverisë, si edhe shumës së kompensimit të propozuar – Gjykata gjykon se nuk është e justifikueshme të vijohet me shqyrtimin e kërkesës (neni 37 § 1 *in fine*).

Së fundmi, Gjykata thekson se nëse Qeveria nuk respekton kushtet e deklaratës së saj të njëanshme, kërkesa mund të rikthehet në listë në përputhje me nenin 37 § 2 të Konventës (shih *Josipović kundër Serbisë* (vend.) nr. 18369/07, 4 mars 2008).

Për sa më sipër, është me vend që çështja të çregjistrohet nga lista.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime,

Mban në konsideratë kushtet në deklaratën e Qeverisë së paditur dhe angazhimin për të respektuar premtimet e referuara në atë deklaratë;

Vendos ta çregjistrojë kërkesën nga lista e saj e çështjeve në përputhje me nenin 37 § 1 (c) të Konventës.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 6 mars 2025.

Viktoriya Maradudina

ZËVENDËSEKRETARE E
PËRKOHSHME

**Oddný Mjöll
Arnardóttir**
KRYETAR

SHTOJCË

Kërkesa me anë të së cilës paraqiten ankesa në mbështetje të nenit 6 § 1 të Konventës
(kohëzgjatje e tepërt e procedurave civile)

Kërkesa nr. Data e paraqitjes	Emri i kërkueses Viti i lindjes	Emri dhe vendndodhja e përfaqësuesit	Data e marrjes së deklaratës së Qeverisë	Shuma e akorduar për dëmin pasuror dhe jopasuror, dhe kostot dhe shpenzimet për kërkues (në euro) ¹
40224/18 21.8.2018	ZORBA Majlinda 1967	BERXOLLI Pranvera Tiranë	24.10.2024	900

¹ Plus çdo taksë që mund t'i tarifohet kërkueses.

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE
TË NJERIUT

SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 57726/21
Drita XHEKA
kundër Shqipërisë

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 23 janar 2025, si Komitet i përbërë nga:

Oddný Mjöll Arnardóttir, *kryetar*,

Úna Ní Raifeartaigh,

Mateja Đurović, *gjyqtarë*,

dhe Viktoriya Maradudina, *zëvendëskancelare në detyrë e Seksionit*,

Duke pasur parasysh kërkesën më sipër të depozituar më 12 nëntor 2021,

Pas diskutimit, vendosi si më poshtë:

FAKTE DHE PROCEDURA

Kërkuesja znj. Drita Xheka ka lindur në vitin 1965.

Ankimet e kërkuësës sipas nenit 6 § 1 dhe nenit 13 të Konventës në lidhje me kohëzgjatjen e procesit dhe mungesën e mjeteve të efektshme juridike në këtë drejtim i janë komunikuar qeverisë shqiptare (“Qeveria”), që dorëzoi parashtrimet për pranueshmërinë dhe themelin. Parashtrimet ju dërguan kërkuësës, e cila u ftua që të paraqitë parashtrimet e saj. Sekretaria nuk mori asnjë përgjigje për shkresën.

Me shkresën e datës 8 tetor 2024 dërguar me rekomandë, kërkuësja u njoftua që periudha e lejuar për paraqitjen e parashtrimeve të saj kishte mbaruar më 8 gusht 2024 dhe nuk ishte kërkuar shtyrje kohe. Në vëmendje të kërkuësës u soll neni 37 paragrafi 1 (a) i Konventës, sipas të cilit Gjykata mund të vendosë të heqë nga lista e çështjeve një kërkesë, kur rrethanat çojnë në përfundimin që kërkuësi nuk ka ndërmend ta ndjekë kërkesën. Kërkuësja e mori shkresën e 29 tetorit 2024. Megjithatë, nuk vijoi asnjë përgjigje.

LEGJISLACIONI

Nisur nga sa më sipër dhe në mungesë të ndonjë rrethane të veçantë në lidhje me respektimin e të drejtave të garantuara nga Konventa dhe Protokollat e saj, Gjykata, në përputhje me nenin 37 § 1 (a) të

Konventës, vlerëson që nuk justifikohet më vazhdimi i shqyrtimit të kërkesës.

Në këto rrethana, çështja duhet të hiqet nga lista.

Për këto arsye, Gjykata, unanimisht,

Vendos të heqë kërkesën nga lista e çështjeve të saj.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 13 shkurt 2025.

Viktoriya Maradudina

ZËVENDËSKANCELARE NË
DETYRË

**Oddný Mjöll
Arnardóttir**

KRYETAR

VENDIM

Nr. 123, datë 24.1.2025

**AUTORIZIM I NDIHMËS
SHTETËRORE “FONDI PËR
NDËRMARRJET MIKRO, TË VOGLA
DHE TË MESME PËR VITIN 2025”**

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

z. Blendi Gonxhja	kryetar;
znj. Mimoza Dhëmbi	anëtare;
znj. Brikena Qela	anëtare;
znj. Keida Qirko	anëtare;
z. Ahmet Mançellari	anëtar,

në mbledhjen e tij të radhës, të datës 24.1.2025, në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, mori në shqyrtim njoftimin e skemës së ndihmës shtetërore, të njoftuar nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) e mbështetjes me grante nga buxheti i shtetit për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme.

I. Procedura

1. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), me shkresën nr. 93, datë 21.1.2025, ka njoftuar skemën e ndihmës shtetërore “Fondi për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme për vitin 2025”. Në bazë të nenit 20, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson skemën e ndihmës shtetërore, në bazë të planit të ndihmës shtetërore të sipërpërmendur.

II. Përshkrimi i masës

2. *Qëllimi*: Dhënia e përfitimit me fond nga buxheti i shtetit për mbështetjen e ndërmarrjeve



mikro, të vogla dhe të mesme (në vijim NMVM), të cilat synojnë rritjen e konkurrueshmërisë së tyre, zhvillimin e produkteve dhe të shërbimeve, zhvillimin e biznesit kreativ, mbështetjen e grave sipërmarrëse, inovacionin e rinovimin e teknologjisë, me qëllim nxitjen drejt eksportit dhe forcimin e aftësive të NMVM-ve për shërbimet e produktet për një treg të qëndrueshëm.

3. *Baza ligjore e planit të ndihmës*: Plani i ndihmës shtetërore mbështetet në paragrafin 2, të nenit 9, të ligjit nr. 43/2022, “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme” dhe VKM-në nr. 26, datë 10.1.2025, “Për përcaktimin e masës së përfitimit, kriterëve dhe kushteve të veçanta të përfitimit për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, për vitin 2025”.

4. *Kobëzgjatja*: Skema e ndihmës do të zbatohet gjatë vitit 2025.

5. *Dhënësi i ndihmës*: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

6. *Autoriteti përgjegjës për zbatimin e masës*: Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA).

7. *Përfituesit*: Përfitues janë të gjithë NMVM-të, të cilat plotësojnë kriteret e përgjithshme të përcaktuara në pikën 5, të ligjit nr. 43/2022, “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”, si dhe kriteret e veçanta të parashikuara në VKM-në nr. 26/2025.

8. *Shtrirja sektoriale dhe territoriale*: Projekti do të zbatohet në territorin e Republikës së Shqipërisë në të gjithë sektorët e ekonomisë.

9. *Forma dhe vlera e ndihmës*: Skema e mbështetjes me ndihmë shtetërore përfshin kategoritë si vijon:

- për *shpenzimet korrente* të programit ekonomik (04130) “Mbështetje për zhvillimin ekonomik” të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në vlerën 100 000 000 (njëqind milionë) lekë, mbulohen 100% e kostove të miratuara, por jo më shumë se 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë;

- për zërin “*Shpenzimet kapitale*” që përdoret për mbështetjen e projekteve të investimeve, në vlerën 31 830 000 (tridhjetë e një milionë e tetëqind e tridhjetë mijë) lekë, ndihma akordohet për:

a) *projekte për konkurrueshmërinë*, në vlerën 21 830 000 (njëzet e një milionë e tetëqind e tridhjetë mijë) lekë, mbulon 100% të kostove të miratuara, por jo

më shumë se 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë;

b) *projekte në mbështetje të artizanatit*, në vlerën 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë, mbulon 100% të kostove të miratuara, por jo më shumë se 1 000 000 (një milion) lekë.

III. Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore

10. Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson nëse plani i ndihmës shtetërore përbën ndihmë shtetërore në kuptim të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, pra nëse plani ofron një avantazh ekonomik për ndërmarrje, të cilat kanë një ndikim të mundshëm në konkurrencë dhe tregtinë midis shteteve anëtare, që nuk do të ishte përfituar në kushte normale të tregut.

11. Neni 4, pika 1, e ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, përcakton se:

“Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdoq formë e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën, duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara, ose për prodhimin e produkteve të caktuara, për aq sa mund të ketë ndikim në plotësimin e detyrimeve të ndërmarrja nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore”.

12. Gjithashtu, neni 71 “Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike”, i Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare dhe Republikës së Shqipërisë,² përcakton se:

“Praktikat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kriterëve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës të aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit.”.

13. Ligji i ndihmës shtetërore zbatohet vetëm për masat që plotësojnë të gjitha kriteret e përmendura në nenin 4, pika 1, konkretisht: a) burime shtetërore; b) avantazhi ekonomik; c) përzgjedhja; dhe d) efekti në konkurrencë dhe treg.

² Ligji nr. 9590, datë 27.7.2006, “Për ratifikimin e ‘Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare’”.



14. Plani i ndihmës financohet nga buxheti i shtetit dhe administrohet nga AIDA, e cila ka në fokus rritjen e konkurrueshmërisë së sektorit privat, forcimin e potencialit eksportues të vendit, promovimin dhe mbështetjen e investimeve të huaja direkte në Shqipëri, si edhe promovimin e potencialit turistik të vendit. Bazuar në këtë skemë, ndërmarrjet aktive në të gjithë sektorët e ekonomisë do të sigurojnë një avantazh ekonomik në formën e mbështetjes me grante direkte që do të mundësojnë uljen e kostove të tyre të prodhimit/shërbimit. Në këtë mënyrë, ndihma ofron një avantazh ekonomik pasi lehtëson përfituesit nga kostot që do të duhej të përballonin në kushte normale tregu. Skema është selektive, pasi ndihma do t'u jepet vetëm për ndërmarrjet e përzgjedhura nëpërmjet procedurës së aplikimit dhe rezultojnë si fitues nga ky proces. Skema në mënyrë të drejtpërdrejtë mund të shtrembërojë ose kërcënojë të shtrembërojë konkurrencën, pasi forcon pozicionin në konkurrencë të përfituesve të saj në tregun vendas dhe ndërkombëtar.

Në këto kushte, Komisioni vlerëson se, në bazë të nenit 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar, plani i ndihmës është ndihmë shtetërore, e cila është e ndaluar përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj.

IV. Vlerësimi i përputhshmërisë së skemës

15. Komisioni i Ndhmës Shtetërore vlerëson skemën e njoftuar në përputhje me nenin 8, të ligjit nr. 9374/2005, "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar, i cili parashikon:

"Ndihma 'De minimis' është e lejueshme nëse, pavarësisht nga forma ose qëllimi për të cilin i jepet një ndërmarrjeje, nuk kalon vlerën maksimale për një aktivitet të caktuar, për një periudhë financiare prej tre vjetësh."

Mbështetur në kreun II, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 605, datë 31.8.2016, "Për përcaktimin e vlerës maksimale, të kushteve dhe të procedurës për dhënien e ndihmës 'De minimis'", vlera maksimale e lejuar e ndihmës, si dhe kushtet për autorizimin e ndihmës përcaktohen si vijon:

"1. Ndihma lejohet nëse përmbushen, njëherësh, të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) vlera totale e ndihmës dhënë një ndërmarrjeje të vetme nuk i kalon 14.000.000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, për një periudhë financiare prej tre vjetësh, e llogaritur në përputhje me kushtet dhe parimet e parashtruara në kreun 3 të këtij vendimi;

b) ndihma është transparente, nëse ekuivalenti bruto i grantit (EBG) mund të llogaritet me saktësi para dhënies së ndihmës, pa pasur nevojë të kryhet një vlerësim risku për konkurrencën, në përputhje me kërkesat dhe parimet e parashtruara në kreun 4 të këtij vendimi."

Në kreun III "Llogaritja e ekuivalentit bruto të grantit", të VKM-së nr. 605, datë 31.8.2016, përcaktohet se: "1. Granti dhe subvencioni në të holla janë ndihmë transparente."

Sa më sipër, bazuar në ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar dhe VKM-së nr. 605/2016, ndihma "De minimis" lejohet, nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:

a) vlera totale e ndihmës dhënë një ndërmarrjeje nuk i kalon 14.000.000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, për një periudhë financiare prej tre vjetësh. Ky kusht plotësohet duke qenë se ndihma shtetërore për një ndërmarrje është deri në vlerën 2,500,000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë;

b) ndihma duhet të jepet për një periudhë financiare prej tre vjetësh. Kohëzgjatja e skemës, e cila është marrë në shqyrtim, është një vit, duke plotësuar këtë kusht ligjor;

c) ndihma është transparente. Ky kusht plotësohet sepse ndihma jepet në formën e grantit.

Sa më lart, Komisioni vlerëson se plani i ndihmës shtetërore është i lejueshëm, në përputhje me nenin 8, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, në bazë të neneve 4, 8/1, 22, dhe 31, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar:

VENDOSI:

1. Të autorizojë skemën e ndihmës shtetërore në formën e grantit "Fondi për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme për vitin 2025", të miratuar me VKM-në nr. 26, datë 10.1.2025, "Për përcaktimin e masës së përfitimit, kriterëve dhe kushteve të veçanta të përfitimit për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, për vitin 2025".

2. Çdo përfitues i ndihmës duhet të nënshkruaj deklaratën e ndihmës "De minimis" dhe të dorëzoj një kopje të deklaratës pranë AIDA-s. Vlera totale e ndihmës së dhënë një ndërmarrjeje nuk duhet të



kalojë 14.000.000 (*katërmëdhjetë milionë*) lekë, për një periudhë financiare prej *tre vjetësh*.

3. AIDA, brenda datës 31 mars të çdo viti, të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar. Raportet e zbatimit duhet të përmbajnë informacion të detajuar mbi shpenzimet e bëra dhe produktet e arritura.

4. Të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës të ruhen deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

5. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONI I NDIHMËS SHTETËRORE

Kryetar: Blendi Gonxhja

Anëtarë: Mimoza Dhëmbi, Brikena Qela, Keida Qirko, Ahmet Mançellari



Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006



Çmimi 112 lekë